



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:067984

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06288906

KF.nr.642/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “B.M.” B.I. me NUI 810370619 me seli në fshatin Qylagë, pn. Lipjan, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi-ndëshkim tatimor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 08.10.2024 në prani të paditësit, pronarit B.M., dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “B.M.” B.I. me NUI 810370619 me seli në fshatin Qylagë, pn. Lipjan, si e pabazuar.
- II. MBETET NË FUQI vendimi nr.19/2022 i datës 14.03.2022, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më datë 05.04.2022, ka inicuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Sipas paditësit, me vendimin nr. 2951 datë 14.12.2021, Zyra për Gjoba e ka dënuar me një gjobë prej 3,298.85 EUR për hapjen e kafesë në stacionin e pompës dhe për moslëshimin e kuponëve fiskalë për mallra dhe pije nga kafja e stacionit të naftës për periudhat: 05.06.2021, 01-03/2020, 06-12/2020, 01-12/2019 dhe 01-03/2018.

Gjatë vizitës së parë më 12.11.2021, paditësi ka informuar inspektoren se kafja është hapur para 2-3 ditësh në lokalin e pompës dhe se janë në periudhë prove apo testimi dhe do të vendoset në javën e ardhshme nëse do të regjistrohet apo të ndërpritet. Janë matur rezervat dhe janë dorëzuar tabelat e matjes. Më 16.11.2021, inspektorja ka bërë një vizitë të dytë, ku paditësi e ka informuar se kanë vendosur të regjistrojnë biznesin. Për këtë çështje, është diskutuar dhe me stafin e regjistrimeve të bizneseve në Komunën e Lipjanit dhe është lënë që regjistrimi të kryhet në atë ditë. Regjistrimi është bërë rreth orës 14:00 dhe kafja është regjistruar si njësi në "Vëllezërit Petrol" - subjekti "B.M." B.I. Në të njëjtën ditë, rreth orës 14:30, inspektoret i është dërguar edhe konfirmimi për regjistrimin e kafesë. Lidhur me mallrat e gjendura në lokalet e pompës (pije, etj.), paditësi ka theksuar se bëhet fjalë për mall të faturuar sipas emrit të biznesit "Vëllezërit Petrol", dhe jo për mall pa origjinë siç është përshkruar. Prova: fatura nr. 101/2021, datë 10.11.2021 me shumën prej 579.04 EUR. Në vendim përmendet gjithashtu se një konsumator ka qenë prezent dhe ka konsumuar pa marrë kupon fiskal. Paditësi pranon këtë fakt, duke deklaruar se nuk kanë pasur ende arkë fiskale për kafe, pasi janë në proces për regjistrimin ose ndërprerjen e kafesë në javën e ardhshme. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, paditësi ka theksuar se qëndron pranë kërkesëpadisë dhe ka njoftuar gjykatën se nuk ka pasur njohuri për statusin e arkës fiskale "transmetimi jo ok," gjë që u kuptua vetëm pas gjobitjes nga inspektori tatimor, megjithëse shitjet janë të deklaruara. Ndërsa për pjesën e gjobës për moskrijimin dhe mosmbajtjen e dokumentacionit në vlerë prej 250 EUR, dhe për konstatimin e mallrave pa origjinë në vlerë ($1,195.4 \text{ EUR} \times 25\% = 298.85 \text{ EUR}$) sipas nenit 59, si dhe për moslëshimin e kuponave fiskalë në vlerë ($1 \times 250 \text{ EUR} = 250 \text{ EUR}$) sipas nenit 53 pika 53.6, paditësi pajtohet. Megjithatë, për pjesën që lidhet me gjobën prej 2,500 EUR për të cilën paditësi nuk ka qenë në dijeni ($20 \times 125 \text{ EUR} = 2,500 \text{ EUR}$), ai nuk pajtohet. Në këtë seancë, paditësi ka rregulluar kërkesëpadinë dhe e ka precizuar, duke kërkuar nga gjykata aprovimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë në mënyrë që të anulohet pjesërisht vendimi i ATK-së nr. 19/2022, datë 14.03.2022, dhe të obligohet e paditura të lirojë paditësin nga ndëshkimi në vlerë prej 2,500 EUR (të ndëshkuar sipas nenit 53.1 për secilën pasqyrë të pa dorëzuar), ndërsa pjesa prej 798.85 EUR nuk kontestohet nga paditësi.

E paditura, në përgjigjen ndaj padisë të datës 11.09.2024, i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga paditësi, duke i vlerësuar ato si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale. Sipas ATK-së, vendimi i kontestuar i Divizionit të Ankesave është i drejtë dhe në përputhje të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Ka shtuar se, lidhur me pretendimin e paditësit se lokali është i ri dhe është hapur vetëm si provë, dhe i njëjti është

regjistruar si njësi e biznesit “Vëllezërit Petrol” dhe se malli në lokal nuk ka qenë pa origjinë por ka qenë i blerë me faturë të rregullt nga IDE – market me datë 10.11.2021 në vlerë prej 579.04 EUR, ATK konstaton se paditësi në momentin e vizitës nuk ka pasur asnjë dokument të nevojshëm për identifikim të origjinës së mallit. Ndërsa sipas krahasimit të mallit sipas faturës në fjalë dhe regjistrimit nga vizita në vendin e ngjarjes, artikujt janë të ndryshëm, prandaj Vendimi i Divizionit të Ankesave është i bazuar në fakte dhe mbështetet në dispozitat ligjore të cekura më lart. Lidhur me pretendimin e paditësit se kafiteria është biznes i ri, e paditura konstaton se paditësi është biznes i regjistruar në vitin 2000 dhe njësitë e tjera janë pjesë integrale e biznesit amë. Gjithashtu, biznesi ka pasur arkë fiskale, por nuk ka lëshuar kuponë fiskalë.

Gjykata e ka shqyrtuar këtë kontest tregtar-administrativ në përputhje me dispozitat e nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur, e cila përmes parashtresës së datës 07.10.2024 ka njoftuar gjykatën se nuk do të marrë pjesë në seancë, duke kërkuar nga gjykata të veprojë në përputhje me nenin 38, paragrafi 5 të LKA-së. Gjithashtu, gjykatës i ka propozuar që të refuzohet padia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 07.10.2024, ka administruar provat si në vijim: Përgjigje ndaj padisë e datës 11.09.2024, Ankesa e paditësit në Divizionin e Ankesave e datës 14.03.2022, Vendimi i Zyrës për Gjopa dhe Ndëshkime Administrative nr. 2951/2021 i datës 14.12.2021, Njoftimi i vlerësimit i datës 14.11.2021, Formë për vizitat përmbushëse e datës 19.11.2021, Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera e datës 22.11.2021, Vendimi nr. 19/2022 i datës 14.03.2022, Fletë regjistrimi i mallit i datës 16.11.2021 dhe 27 Z raporte periodike.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, pretendimet në padi, përgjigjen ndaj padisë, dhe shkresat e lëndës në këtë kontest tregtar-administrativ, duke bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar-administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se Zyra për Gjopa dhe Ndëshkime Administrative me datë 14.12.2021 ka marrë

vendim nr. 2951/2021 mbi shqiptimin e ndëshkimit administrativ për secilën pasqyrë të pa dorëzuar në vlerë prej $20 * 125 \text{ EUR} = 2,500 \text{ EUR}$, për shkak të mos krijimit dhe mos mbajtjes së dokumentacionit në vlerë prej 250 EUR, për shkak të konstatimit të mallrave pa origjinë në vlerë prej $1,195.40 * 25\% = 298.58 \text{ EUR}$ dhe për shkak të mos lëshimit të kuponëve fiskalë në vlerë prej $1 * 250 \text{ EUR} = 250 \text{ EUR}$. Jo kontestuese është edhe fakti se tatimpaguesi, këtu paditësi, ka parashtruar ankesë me datë 16.11.2021 në Divizionin e Ankesave kundër vendimit të lartcekur. Po ashtu, jo kontestuese mbetet edhe fakti se Administrata Tatimore e Kosovës - Divizioni i Ankesave, me datë 14.03.2022 ka marrë vendimin nr. 19/2022, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 05.04.2022 ka iniciuar këtë kontest tregtar-administrativ. Kontestuese mbetet nëse pretendimet e paditësit lidhur me mos dijeninë për “transmetimin jo ok” janë të bazuara në prova dhe dispozita ligjore.

Gjykata, pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka arritur në përfundimin se e paditura ka vepruar në përputhje me detyrimet e saj ligjore. Paditësi, gjatë seancës, ka paraqitur pretendime të cilat nuk kanë qenë të parashtruara në procedurën administrative, duke theksuar se nuk ka pasur njohuri për statusin e arkës fiskale “transmetimi jo ok” dhe se këtë e ka kuptuar pasi është gjobitur; për gjykatën, kjo është e pabazuar, pasi paditësi as në procedurën administrative, as në procedurën para gjykatës nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se ka raportuar pasqyrat për të cilët është ndëshkuar dhe të cilët i konteston në këtë gjykatë.

Meqenëse paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor ka precizuar kërkesëpadinë për gjobën lidhur me secilën pasqyrë të pa dorëzuar në vlerë prej 2,500 EUR, gjykata nuk ka shqyrtuar më tej padinë që lidhet me gjobën për mos krijimin dhe mos mbajtjen e dokumentacionit në vlerë prej 250 EUR, për konstatimin e mallrave pa origjinë në vlerë prej 298.85 EUR, si dhe për mos lëshimin e kuponëve fiskalë në vlerë prej 250 EUR.

Gjykata, nga administrimi i Z-raporteve të bashkangjitura padisë, të cilat të gjitha mbanin shënimin “transmetimi ok,” e vlerësoi të pabazuar pretendimin e paditësit se disa raporte kishin mesazhin “transmetimi jo ok” dhe se ai nuk kishte njohuri për domethënien e këtij mesazhi. Ky pretendim konsiderohet i pambështetur në prova përkatëse, pasi paditësi nuk e ka paraqitur as në procedurën e ankesës tek e paditura dhe as në këtë procedurë të konfliktit administrativ, dhe nuk ka ofruar prova që mbështesin këtë pretendim, përfshirë Z-raportet e pa transmetuar.

Mosdorëzimi, mos krijimi ose mos paraqitja e të dhënave është rregulluar me nenin 53 të Ligjit nr. 03/L-222 ku në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Përveç nëse parashihet ndryshe, çdo person nga i cili kërkohet të dorëzojë një pasqyrë informatash në ATK dhe i cili nuk e bën këtë deri në datën obliguese apo i cili dorëzon një pasqyrë të pasaktë ose jo complete do t’i nënshtrohet një sanksioni prej njëqindnjëzetepesë (125) Euro për secilën pasqyrë të padorezuar, për secilën pasqyrë të pasaktë apo të pakompletuar, deri në maksimum prej dymijepesëqind (2,500) Euro.”*

Bazuar në këtë, gjykata arrin në përfundimin se e paditura ka vepruar drejtë dhe në përputhje me ligjin, dhe paditësi nuk ka arritur të dëshmojë se ka pasur pengesat e pretenduara për mos dorëzim të pasqyrës për shkak të së cilës edhe është ndëshkuar nga e paditura.

Neni 43, paragrafi 1 i LKA-së, *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative,”* andaj paditësi në këtë konflikt administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështesë pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin 81 F, paragrafi 1 dhe 81 E, paragrafi 4, pika 4 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222. Ndërsa neni 7 par.1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla,”*. Nga kjo rezulton se barra e të provuarit në procedurë bie mbi paditësin që në rastin konkret të dëshmojë për pengesat e mos paraqitjes së pasqyrave për të cilat ishte ndëshkuar nga e paditura.

Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se vendimi kontestuese i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43, paragrafi 1, dhe nenit 46, paragrafi 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.642/22, datë 08.10.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.